



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 123/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.12.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ARITECH SHPK" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me kompjuter dhe laptop - Lot 2", me Nr. të Prok: 632-20-4552-1-2-1, nxjerr:

### VENDIM

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të "ARITECH SHPK" e dates 28.12.2020, lidhur me aktivitetin e **Furnizim me kompjuter dhe laptop - Lot 2**, me Nr. të Prok: 632-20-4552-1-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 23.12.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 23.12.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Arsyetim

Operatori Ekonomik **ARITECH SHPK** me datë 28.12.2020, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Furnizim me kompjuter dhe laptop - Lot 2"**, me Nr. të Prok: **632-20-4552-1-2-1**,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.12.2020, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK sqaron se nuk ka bere shkelje te neneve 6, 7, 28 dhe 59 pasi qe:

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankeus se OE mund të ofertojnë me produkte të cilat plotësojnë kërkesën e AK apo e tejkalojnë atë, AK sqaron se në dosje të tenderit nuk është dhënë kjo pikë meqenëse në dosje të tenderit është kërkuar "Madhësia e Ekranit: 54.6" pra nuk është lejuar e as nuk është kërkuar që të tejkalohej kjo specifike teknike.

Po ashtu, sipas njesise kerkuese, specifikat e kerkuara jane fikse dhe me qellim jane detalizuar sepse disa shkolla kane vende specifike per montim te cilat ju pershtaten me disa tabela ekzistuese qe do te thote madhesia e TV nuk guxon te jete me e madhe sic eshte parapare andaj nuk mund te pranohet TV me specifika te OE ankues.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se cmimi juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës

